

Kur ju merrni një vendim pozitiv për kërkesën tuaj për azil

Pasi të keni marrë një vendim pozitiv për kërkesën tuaj për azil, ne e dimë se ndoshta do të keni shumë gjëra për të menduar. Këto mund të përfshijnë planet tuaja për të studiuar, për të punuar ose për të udhëtuar për të takuar njerëzit tuaj të dashur. **Pasi të keni marrë vendimin, keni vetëm një kohë të shkurtër përpara se të përfundojë mbështetja juaj nga azili, kështu që është e rëndësishme që së pari të përqendroheni në këto tre gjëra.**

1. Dëshmia e statusit dhe identifikimit – eVisa (Viza Elektronike) juaj

- Mbretëria e Bashkuar po kalon në një sistem dixhital imigrimi. Nga 31 Tetori 2024, Home Office filloi lëshimin e **eVisas** në vend të Lejeve Biometrike të Qëndrimit (BRP).
- Viza juaj elektronike është shumë e rëndësishme. Do t'ju duhet për të gjetur një punë ose për të kërkuar ndihma dhe për të marrë me qira një vënd për të jetuar.
- Home Office do të krijojë llogarinë tuaj për Vizat dhe Imigracionin në Mbretërinë e Bashkuar (UKVI) dhe eVisa-n tuaj brenda 14 ditëve nga data e marrjes së vendimit pozitiv. Ata do t'ju dërgojnë informacionin e nevojshëm që ju duhet për të hapur dhe për të hyrë në llogarinë tuaj në eVisa.
- Nëse nuk i merrni detajet e llogarisë suaj UKVI, ose nëse keni nevojë për ndihmë për të hyrë në eVisa-n tuaj, ju lutemi kontaktoni Qendra e Rezolucionit UKVI duke përdorur webchatin e tyre online (shkoni te www.gov.uk/evisa dhe klikoni "If you need help" (Nëse keni nevojë për ndihmë), ose kontaktoni Migrant Help (ndihmën e emigrantëve) në 07483 170100 ose evisa@migranthelpuk.org
- Nëse ka ndonjë gabim në eVisa-n tuaj, ju lutemi kontaktoni UKVI në www.gov.uk/report-error-evisa

2. Paratë tuaja

- Pasi të keni marrë një vendim pozitiv, ju lejohet të punoni dhe të fitoni para.
- nuk mund të punoni ose nuk mund të gjeni një punë shpejt, duhet të aplikoni për ndihma sociale (zakonisht Universal Credit). Mund të aplikoni online ose personalisht në qendrën tuaj më të afërt të Job Centre Plus.
- Bëjeni këtë menjëherë pasi mund të duhet pak kohë përpara se të merrni pagesat tuaja.
- Nëse nuk e keni kartën BRP (Lejen e Rezidences Biometrike), mund të përdorni letrën tuaj të Grantit të Azilit dhe kartën ARC për të aplikuar për ndihma sociale.
- Do t'ju duhet gjithashtu të hapni një llogari bankare.

3. Strehimi juaj

- Pasi të keni një vendim pozitiv, mund të filloni të kërkoni dhe të zhvendoseni në banesën tuaj.
- Mund t'i kërkoni Bashkisë tuaj lokale (aty ku jetoni kur merrni vendimin tuaj) t'ju ndihmojë. Nëse në përgjithësi jeni të shëndetshëm dhe nëse nuk keni fëmijë që jetojnë me ju, nuk do të shiheni si prioritet dhe nuk ka gjasa t'ju ofrojnë ndonjë strehim. Për momentin ka një mungesë të madhe të banesave sociale dhe akomodimit bashkiak për të gjithë njerëzit.

Strehimi ABC

A Së pari – **pranoni** që vendi i parë që gjeni mund të jetë vetëm afatshkurtër. Mund të jetë strehim i vogël, i përbashkët ose i përkohshëm dhe jo në zonën ku dëshironi të jetoni.

B Së dyti – pasi të keni disa të ardhura dhe/ose një punë, mund të kërkoni një vend **më të mirë** për të marrë me qira që është më afër asaj që dëshironi, por gjithsesi i përballeshëm. Gjëra të tilla si klasa për mësimin e anglishtes dhe mbështetja e punësimit do t'ju ndihmojnë ta bëni këtë.

C Më vonë – punoni për të shkuar drejt një shtëpie të **rehatshme** ku dëshironi të jetoni për një afat më të gjatë.

